



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 352/3 prot.

Tiranë, më 10.07.2020

VENDIM

Nr.55, datë 10.07.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 140, DATË 20.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 140, datë 20.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Mirditë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Mirditë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Mirditë, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 140, datë 20.11.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 2 (dy) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Mirditë, me shkresën nr.1464/2 prot., datë 03.06.2020, *“Dërgim informacioni”*, dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike në datën 02 korrik 2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Mirditë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, është konstatuar pavlefshmëria absolute e akteve, duke ndërprerë marrëdhënien e punësimit në kundërshtim me ligjin, për punonjëset: ***** dhe *****.
2. Njësia përgjegjëse ka vijuar dhe është duke realizuar procedurat e konkurrimit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.
3. Me urdhrin nr. 640 prot., datë 18.2.2020, Bashkia Mirditë ka hartuar dhe miratuar planin vjetor të rekrutimit në shërbimin civil për pozicionet e parashikuara në strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 38, datë 17.2.2020, *“Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë, institucioneve të varësisë dhe NJA-ve për vitin 2020”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 140, datë 20.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Mirditë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në*

strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Mirditë.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Mirditë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha